



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHMË RREGULLATORE DHE PËRPUTHSHMËRISË
DREJTORIA E INSPEKTIMIT FINANCIAR PUBLIK

Tiranë, më.....2021

AKT KONSTATIM NR.1

I mbajtur sot më datë 17.12.2021, në subjektin: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë/Strukturat Përgjegjëse dhe Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), nga Inspektorët Financiarë Publik Z.Shensi Mikli, Znj. Ermonela Sina dhe Z.Osman Losha, me përfaqësuesit e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Z.Enea Karakaci, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm dhe Z.Ilia Gjermani, me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Hidrokarbureve, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe Z.Viktor Tushaj, ish Drejtor Ekzekutiv, Z.Elion Selmanaj, ish Drejtor Ekzekutiv, Z.Adrian Bykyku, me detyrë Drejtor Ekzekutiv, ish Drejtor i Hidrokarbureve, në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore, lidhur me inspektimin financiar publik të kryer në zbatim të Vendimit të Nëpunësit të Parë Autorizues nr.91, datë 05.11.2021 "Për fillimin e inspektimit financiar publik", i ndryshuar, me objekt:

a) Zbatimi i ligjshmërisë lidhur me:

- Procedurat e marrjes në dorëzim të të gjitha aseteve të vendburimeve që ka patur në shfrytëzim shoqëria "TransAtlantic Albania Ltd", nga ana e Agjensisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), si dhe marrja në dorëzim e vendburimit Cakran-Mollaj nga ana e shoqërisë "Albpetrol" sh.a, me përfundimin e Marrëveshjes Hidrokarbure datë 19.07.2007, miratuar me VKM nr.509, datë 08.08.2007 "Për miratimin e marrëveshjes hidrokarbure, për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve me vendburimet Ballsh-Hekal, Gorisht-Cokul, Cakran-Mollaj".
- Procedurat e marrjes në dorëzim të sasisë së naftës, gjendje në depot /magazinat fiskale të vendburimit Cakran-Mollaj, si dhe lëvizja e kësaj sasive naftë, ndërmjet Degës së Doganës Fier dhe shoqërisë "TransAtlantic Albania Ltd", si dhe ndërmjet Degës së Doganës Fier dhe shoqërisë "Albpetrol" sh.a, me përfundimin e Marrëveshjes Hidrokarbure datë 19.07.2007, miratuar me VKM nr.509, datë 08.08.2007.
- Procedurat e magazinimit të sasisë së naftës të kryera nga ana e Degës së Doganës Fier dhe nga ana e shoqërisë "Albpetrol", sh.a, si dhe procedurat e shitjes të kësaj sasive naftë në magazinat fiskale, në vendburimin Cakran-Mollaj, me përfundimin e Marrëveshjes Hidrokarbure datë 19.07.2007, miratuar me VKM nr.509, datë 08.08.2007.

b) Zbatimi i ligjshmërisë lidhur me:

okumentimin, evidentimin, regjistrimin dhe kontabilizimin e detyrimeve financiare të krijuara nga ana e shoqërisë "TransAtlantic Albania Ltd", kryer nga ana e Degës së Doganës Fier, si dhe nga ana e shoqërisë "Albpetrol" sh.a, gjatë dhe me përfundimin e Marreveshjes Hidrokarbure datë 19.07.2007, miratuar me VKM nr.509, datë 08.08.2007.

c) Zbatimi i ligjshmërisë lidhur me:

- Përdorimin e të ardhurave të krijuara nga shitja e sasisë së naftës, gjendje në magazinat fiskale të vendburimit Cakran-Mollaj, kryer nga ana e shoqërisë "Albpetrol" sh.a.

I. Mbi marrëveshjen hidrokarbure si dhe licencë marrëveshjen, të lidhura ndërmjet Ministrisë përgjegjëse për industrinë (ish METE), AKBN-së, shoqërisë "Alpetrol" sh.a, dhe shoqërisë "TransAtlantic Albania Ltd", ish shoqëria "STREAM OIL&GAS Limited".

Nga verifikimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për grupin e inspektimin, nga strukturat përgjegjëse të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, AKBN dhe shoqërisë "Alpetrol" sh.a, rezulton:

- ✓ Më datë 04.07.2007, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës të përfaqësuar prej Agjensisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), përfaqësuar nga Z. Milo Kuneshka, me detyrë Kryetar i AKBN-së (referuar Autorizimit të Ministrit të Ekonomisë Tregtisë dhe Energjitikës për përfaqësimin e METE nga AKBN, përfaqësuar nga Z.Kunshka) dhe shoqërisë "Albpetrol" sh.a, përfaqësuar nga Z. Ylli Gjoni, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm, është lidhur Licensë Marrëveshje, me të dhënat sa vijon:
 - Objekt të Licensë Marrëveshjes: "Për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin..."Cakran-Mollaj".
 - Kohëzgjatje të Licensë Marrëveshjen Hidrokarbure: 18 muaj nga data efektive e Licensë Marrëveshjes, që përkon nga data 04.07.2007 deri datë 04.01.2009.
- ✓ Licensë Marrëveshja Hidrokarbure, datë 04.07.2007, ka në bashkëlidhje të saj Anekset respektive sa vijon:
 - Aneksi "A": Zona e kontratës, Harta dhe koordinatat gjeodezike të zonës së kontratës, Blloku "Cakran-Mollaj", me 8 (tetë) koordinata "X" dhe "Y".
 - Aneksi "B": Programi minimal i punës për periudhën e vlerësimit. (Referuar nenit 2 "Anekset e Licensë marrëveshjes" të kësaj licensë marrëveshje datë 04.07.2007).
- ✓ Më datë 19.07.2007, ndërmjet Agjensisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), përfaqësuar nga Z. Milo Kuneshka, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm, shoqërisë Albpetrol sh.a, përfaqësuar nga Z.Ylli Gjoni, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm dhe Kompanisë/Kontraktorit Stream Oil & Gas Limited, përfaqësuar nga Dr. Sotiris Kapotas, President&CEO, është lidhur Marrëveshja hidrokarbure, me:

Objekt të Marrëveshjes/Kontratës: Për operacione vlerësimi, zhvillimi dhe prodhimi të hidrokarbureve në zonën e kontratës... "Cakran-Mollaj".

- Kohëzgjatje të marrëveshjes/Kontratës: 18 muaj nga data efektive e Marrëveshjes/Kontratës që përkon nga data 19.07.2007 deri datë 18.01.2009.

✓ Marrëveshja hidrokarbure datë 19.07.2007, ka në bashkëlidhje të saj Aneksat respektive sa vijon:

- Aneksi "A": Zona e kontratës, Harta dhe koordinatat gjeodezike të zonës së kontratës, Blloku "Cakran-Mollaj", me 9 (nëntë) koordinata "X" dhe "Y".
- Aneksi "B": Procedura llogaritëse.
- Aneksi "C": Formë Garancie Bankare drejtuar Agjensisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN).
- Aneksi "D": Programi i vlerësimit.
- Aneksi "E": Instrumenti i transferimit datë 19 Korrik 2007. (Nënshkruar nga: Z. Milo Kuneshta, Drejtor i Përgjithshëm në AKBN; Z. Ylli Gjoni, Drejtori i Përgjithshëm në shoqërinë Albpetrol sh.a; Z. Sotiris Kapotas, President&CEO i Kontraktorit Stream Oil&Gas Limited).
- Aneksi "F": Procedura e marrjes në dorëzim.

✓ Më datë 19.07.2007 është nënshkruar Marrëveshja hidrokarbure, në emër dhe për llogari të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës (METE), me Autorizimin e Ministrit të METE, nga Z. Milo Kuneshta, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm në AKBN.

- Referuar Ekstraktit historik të QKB-së datë 28.01.2021, kontraktori i kësaj Marrëveshje /Stream Oil & Gas Limited, nga data 05.10.2007 dhe deri në mbylljen e marrëveshjes hidrokarbure për vendburimin Cakran-Mollaj, emërtohet:

- o Kontraktori kësaj Marrëveshje/TransAtlantik Albania L.t.d, me këto të dhëna:

- Numri Unik i Identifikimit të Subjektit (NUIS): K 72205016 P.
- Data e regjistrimit: 05.10.2007
- Emri i subjektit: Trans Atlantik Albania L.t.d-Dega shqiptare.
- Forma ligjore: Degë e shoqërisë së Huaj.
- Fusha e veprimtarisë; Shfrytëzim. Prodhim dhe Zhvillim i Hidrokarbureve, etj.
- Përfaqësuesi/it ligjor i Degës/Zyrës së përfaqësimit në Shqipëri: Z. Naim Kasa, nga data 29.02.2016 deri në mbylljen e kësaj marrëveshje hidrokarbure.
- Statusi: Aktiv.

- Marrëveshja hidrokarbure datë 19.07.2007 lidhur ndërmjet palëve, sa më lart cituar, për vendburimin Cakran-Mollaj, dokumentohet të jetë bërë efektive me datë 08.08.2007 dhe afati i kësaj marrëveshje, përkon nga data 08.08.2007 deri datë 08.02.2009. (Referuar nenit 4 "Afatet" dhe nenit 7 "Programet vjetore dhe buxhetet", nënpika 7.3" Periudha e vlerësimit" të kësaj licensë marrëveshje).

✓ Licensë Marrëveshja, datë 04.07.2007, si dhe Marrëveshja hidrokarbure, datë 19.07.2007, e lidhur ndërmjet palëve, sa më lart përmendur, është miratuar me VKM nr.509, datë 08.08.2007 "Për miratimin e marrëveshjes hidrokarbure, për zhvillimin dhe prodhimin e

hidrokarbureve në vendburimet Ballsh-Hekal, Gorisht-Kocul, Cakran-Mollaj dhe në vendburimet e Delvinës, ndërmjet Albpetrol sh.a dhe Stream Oil & Gas Limited”.

Këshilli i Ministrave, me Vendimin nr.509, datë 08.08.2007, ka vendosur:

1. Miratimin e marrëveshjeve hidrokarbure, për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Ballsh-Hekal, ndërmjet Albpetrol sh.a.-së dhe STREAM OIL&GAS Limited, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Miratimin e marrëveshjes hidrokarbure për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Gorisht-Kocul, ndërmjet Albpetrol sh.a.-së dhe STREAM OIL&GAS Limited, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Miratimin e marrëveshjes hidrokarbure, për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Cakran-Mollaj, ndërmjet Albpetrol sh.a.-së dhe STREAM OIL&GAS Limited, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
4. Miratimin e marrëveshjes hidrokarbure për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin e Delvinës, ndërmjet Albpetrol sh.a.-së dhe STREAM OIL&GAS Limited, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
5. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

II. Mbi mbylljen/prishjen e njëanshme të Marrëveshjes hidrokarbure, të lidhur mw datë 19.07.2007, për vendburimin Cakran-Mollaj (Mbi ndërveprimin zyrtar të zhvilluar ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, strukturat përgjegjëse me AKBN dhe shoqërinë “Alpetrol” sh.a, lidhur me detyrimet e shoqërisë “TransAtlantic Albania Ltd”, ish shoqëria “STREAM OIL&GAS Limited”.

Referuar nenit 24 “Mbyllja”, nënpika 24.2.1, të Marrëveshjes hidrokarbure, rezulton se:

- ✓ Me shkresën nr.813 Prot, datë 04.04.2016, si dhe me shkresën nr.813/5 dhe 813/6 datë 07.03.2016, Administratori i Shoqërisë Albpetrol sh.a, Z.Endri Puka, i është drejtuar Kontraktorit TransAtlantik Albania Ltd, mbi rikujtesën për detyrimet e materializuara/akumuluara për shoqërinë Albpetrol sh.a sipas marrëveshjes hidrokarbure për vendburimin Cakran-Mollaj.
- ✓ Me shkresën nr.2268/1 Prot, datë 10.02.2016, Administratori i Shoqërisë Albpetrol sh.a, Z.Endri Puka, i është drejtuar, Ministrit të MEI, Z. Damian Gjikhuri, ku ka informuar mbi dhe për detyrimet e materializuara/akumuluara për shoqërinë Albpetrol sh.a nga ana e Kontraktorit TransAtlantik Albania Ltd, sipas marrëveshjes hidrokarbure për vendburimin Cakran-Mollaj si dhe mbylljen e kësaj marrëveshje.
- ✓ Me shkresën nr.6265 Prot, datë 19.09.2016 (protokolluar në AKBN nr.8355, datë 28.09.2016)
Administratori i Shoqërisë Albpetrol sh.a, Z.Endri Puka, i është drejtuar, Kontraktorit TransAtlantik Albania Ltd, si dhe për dijeni Ministrit të MEI, Z. Damian Gjikhuri,

Tushaj, Drejtor Ekzekutiv pranë AKBN-së, ku ka njoftuar: "Mbi mbylljen e marrëveshjes hidrokarbure për vendburimin Cakran-Mollaj, si dhe ka sjellë në vëmendje detyrimet e materializuara/akumuluar për shoqërinë Albpetrol sh.a nga Kontraktori TransAtlantik Albania L.t.d, ku citon se: ".....duke marrë parasysh se TransAtlantik Albania L.t.d, nuk është angazhuar me qëllim korrigjimin e shkeljeve material të njoftuar nga Albpetrol sh.a, brenda afatit 6 muaj në zbatim të parashikimeve kontraktuale, Albpetrol sh.a , Ju njoftoj zyrtarisht mbylljen e Marrëveshjes hidrokarbure "Për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Cakran-Mollaj.....kjo mbyllje do të bëhet efektive në përfundim të afatit 120 ditë nga marrja e këtij njoftimi...."

- ✓ Me shkresën nr.6265/3 Prot, datë 24.10.2016, Administratori Shoqërisë Albpetrol, Z. Puka, i është drejtuar Kontraktorit TransAtlantik Albania Ltd, si dhe për dijeni Ministrit të MEI, Z. Damian Gjiknuri, Ministrit të Financave Z. Arben Ahmetaj, Ministrit të METE-s, Znj. Milva Ekonomi, dhe Drejtorit Ekzekutiv të AKBN-së, Z. Viktor Tushaj, ku ka njoftuar: *Mbi mbylljen e marrëveshjes hidrokarbure për vendburimin Cakran-Mollaj, si dhe duke sjellë në vëmendje detyrimet e materializuara/akumuluar për shoqërinë Albpetrol sh.a nga Kontraktori TransAtlantik Albania L.t.d.*
- ✓ Me shkresën nr.8355/3 Prot, datë 18.10.2016 (protokolluar në Shoqërië Albpetrol sh.a nr.6265 Prot, datë 21.10.2016) Drejtor Ekzekutiv në AKBN/ Z.Tushaj, i është drejtuar Kontraktorit TransAtlantik Albania Ltd, dhe Administratorit të shoqërisë Albpetrol sh.a, Z. Puka, si dhe për dijeni Ministrit të MEI, Z. Damian Gjiknuri, ku ka njoftuar: "Mbi mbylljen e marrëveshjes hidrokarbure për vendburimin Cakran-Mollaj, si dhe gjetjen e një zgjidhjeje të pranueshme për mosmarrëveshjet e lindura dhe të krijuara midis palëve ...si dhe duke marrë masa edhe për parandalimin e humbjeve ose përhapjen e hidrokarbureve mbi ose nën tokë".
- ✓ Me shkresën nr.404 Prot, datë 20.01.2017, Administratori i Shoqërisë Albpetrol sh.a, Z. Puka, i është drejtuar Ministrit të MEI, Z. Damian Gjiknuri dhe për dijeni Drejtor Ekzekutiv i AKBN-së, Z. Tushaj, ku ka informuar mbi ecurinë e Marrëveshjeve Hidrokarbure për vendburimet Cakran-Mollaj dhe Gorisht-Kocul të lidhura me Kontraktorin TransAtlantik Albania L.t.d, ku ndër të tjera citohet se: ".....TransAtlantik Albania L.t.d rezulton me detyrime përkatësisht:
 - Detyrim debitor në lekë për faturat e shërbimeve të palikujduara, në vlerën prej 96 494 483 lekë.
 - Detyrimi debitor në USD, për fatura të palikujduara në vlerën prej 13 996 426 USD, si dhe në këtë shkresë citohet: "..... Shoqërisë TransAtlantik Albania L.t.d/ish Stream Oil & gas ltd, i janë krijuar më se njëherë të gjitha mundësitë për të shlyer detyrimet që ka akumuluar ndaj Albpetrol sh.a; Pamvarësisht kësaj, dhe megjithë premtimet e tyre të shumta deri më sot nuk kanë arritur as t'i shlyejnë këto detyrime dhe as të paraqisinin një garanci të besueshme nga një institucion i certifikuar që të garantojë shlyerjen e tyre në një afat të caktuar.... Afati 120 ditë i përcaktuar në shkresat nr.6255 dhe nr.6266, datë 19.09.2016, është përmbushur....pra ekzistojnë të gjitha kushtet bazuar në ligjin nr. 7746, datë 28.07.1993, neni 12.2, që shoqëria

Albpetrol sh.a, të autorizohet të vazhdojë operacionet hidrokarbure në zonën e kontratës së Marrëveshjes hidrokarbure për vendburimin Cakran-Mollaj dhe Gorisht-Kocul me të njëjtat kushte si në Licensë Marrëveshjet aktuale që janë në fuqi për këto vendburime”.

Në vijim:

- ✓ Me shkresën nr. 431/1 Prot, datë 24.01.2017 (Protokolluar në AKBN nr.1007 datë 25.01.2017) Ministri i MIE, Z. Damian Gjiknuri i është drejtuar Administratorit të shoqërisë Albpetrol. Z. Endri Puka, sh.a dhe Z. Viktor tushaj, Drejtor Ekzekutiv i AKBN-së: “Mbi ecurinë e Marrëveshjeve Hidrokarbure në vendburimet Cakran-Mollaj dhe Gorisht-Kocul të lidhura me TransAtlantik Albania L.t.d”, ndër të tjera citon: “...i) MEI shprehet se shoqëria Albpetrol sh.a, bazuar në klauzolat e ligjit nr.7746, datë 28.07.1993 “Për hidrokarburet (kërkim-prodhim)” i ndryshuar, të vazhdojë të kryejë operacione për zhvillimin dhe shfrytëzimin të hidrokarbureve në vendburimet Cakran-Mollaj dhe Gorisht-Kocul, në përputhje me termat e “Marrëveshja Albpetrol sh.a, si dhe ii) Merrni masa në bashkëpunim me AKBN, duke hartuar një program pune të detajuar për të vazhduar procedurat e marrjes në dorëzim të vendburimeve Cakran-Mollaj dhe Gorisht-Kocul, sipas legjislacionit në fuqi që menaxhon aktivitetin hidrokarbur...si dhe iii)rivënien në punë të puseve të ndaluar brenda një kohe sa më të shkurtër”.
- ✓ Për sa sipër, referuar shkresës nr. 6265 Prot, datë 19.09.2016, marrëveshja Hidrokarbure datë 19.07.2007, e lidhur me Kontraktorin TransAtlantik Albania L.t.d, për vendburimin Cakran-Mollaj, **konsiderohet e mbyllur me datë 19.01.2017** (pasi janë konsumuar të gjithë afatet lidhur me korrigjimin në mënyrë substanciale të shkeljeve material të detyrave dhe detyrimeve themelore për afatin 6 mujor dhe 120 ditor) dhe të gjithë pusët e naftës dhe asetet e tjera në shfrytëzim nga Kontraktori TransAtlantik Albania L.t.d, i kalojnë në administrim dhe në pronësi shoqërisë “Albpetrol” sh.a dhe marrja në dorëzim e tyre do të bëhet nga shoqëria Albpetrol sh.a dhe Agjensia kombëtare e Burimeve Natyrore (referuar nenit 24.2 të Marrëveshjes Hidrokarbure datë 17.07.2007).

III. Mbi procedurat e marrjes në dorëzim të puseve dhe të gjitha aseteve të vendburimit Cakran-Mollaj, që ka patur në shfrytëzim shoqëria “TransAtlantic Albania Ltd”, referuar Marrëveshjes Hidrokarbure datë 19.07.2007, nga ana e shoqërisë “Albpetrol” sh.a.

Nga verifikimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, nga subjekti shoqëria “Albpetrol” sh.a rezulton se:

- ✓ Me shkresën nr.7944 Prot, datë 06.12.2016, në zbatim të shkresës nr.6265 Prot, datë 19.09.2016, Administratori Shoqërisë “Albpetrol” sh.a, Z.Puka, ka njoftuar Kontraktorin TransAtlantik Albania L.t.d, si dhe për dijeni Ministrin e MIE, Z. Damian Gjiknuri dhe Drejtorin Ekzekutiv, pranë AKBN-së, Z. Tusha, “Për fillimin e procesit të marrjes në

zëzim të puseve dhe aseteve të shoqërisë Albpetrol sh.a, në vendburimin Cakran-Mollaj.

- ✓ Me shkresën nr.7865, datë 02.12.2016, në zbatim të shkresës nr.6265 datë 19.09.2016, Administratori Shoqërisë Albpetrol sh.a, Z.Puka, ka urdhëruar ngritjen e Grupit të punës që do të ndjekë procedurat e marrjes në dorëzim të puseve dhe aseteve në vendburimin Cakran-Mollaj, si dhe është urdhëruar: i) Të njoftohet me shkresë zyrtare shoqëria TransAtlantik Albania L.t.d, për fillimin e procesit të marrjes në dorëzim të puseve dhe aseteve të Albpetrol sh.a dhe për punonjësit që janë në përbërje të grupit të punës, si dhe ii) Për zbatimin e pikës 4 të këtij urdhëri, është ngarkuar Drejtoria e Marrëveshjeve Hidrokarbure.
- ✓ Më datë 01.02.2017, nga Grupi i punës sa më sipër cituar, dokumentohet të jetë hartuar Proces verbali për marrjen në dorëzim të puseve dhe të gjithë aseteve në shfrytëzim nga Kontraktori TransAtlantik Albania L.t.d, në administrim dhe në pronësi të shoqërisë Albpetrol sh.a, nga data 01.02.2017 e në vijim.
- ✓ Asetet (puset dhe të gjithë asetet) në shfrytëzim nga Kontraktori "TransAtlantik Albania L.t.d" janë në administrim dhe në pronësi të shoqërisë "Albpetrol" sh.a, si dhe detyrimet e kësaj shoqërie janë kontabilizuar në shoqërinë "Albpetrol" sh.a.

Detyrimi që rrjedh nga mospërmbushja e detyrimeve kontraktuale, përgjatë dhe me mbylljen e marrëveshjes hidrokarbure, në vlerën 15 997 441.49 dollarë dhe në vlerën 2 845 998 232.16 lekë, përfshirë edhe detyrimet për pagat e punonjësve të paguara nga shoqëria "Alpetrol" sh.a, për llogari të shoqërisë "TransAtlantik Albania L.t.d", për periudhën Dhjetor 2016-Janar 2017, në vlerën 5 826 768 lekë, për punonjësit e Sektorit Cakran-Mollaj. Ky detyrim dokumentohet të jetë kontabilizuar në regjistrat dhe librat kontabël të llogarive respektive, të shoqërisë Albpetrol sh.a.

IV. Mbi kërkesën e kontraktorit/shoqërisë "GBC OIL Company Ltd", ish shoqëria "TransAtlantik Albania", ish shoqëria "Stream Oil&Gas ltd", në Gjykatën Ndërkombëtare të Arbitrazhit, të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Zyrih, Zvicër.

- ✓ Shoqëria "GBC OIL Company Ltd", ish shoqëria "TransAtlantik Albania", ish shoqëria "Stream Oil & Gas ltd", në cilësinë e palës paditëse, më datën 17 mars 2017, ka dorëzuar kërkesën për arbitrazh në Gjykatën Ndërkombëtare të Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Zyrih, Zvicër, me palë të paditur Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore dhe shoqërinë "Alpetrol" sha.
- ✓ Kërkesa për gjykim në arbitrazh është bërë në zbatim të Licencë Marrëveshjes respektive të nënshkuara ndërmjet shoqërisë "Stream Oil & Gas ltd"/"TransAtlantik

Albania" dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Energjetikës (METE), përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm i AKBN-së, konkretisht të nenit 25 "Mosëmarrëveshjet dhe arbitrazhi, pikës 25.3, "Arbitrazhi ndërmjet AKBN-së, Albpetrol-it dhe partnerit(eve) të huaj", në të cilën parashikohen se: *"Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin në lidhje me këtë License Marrëveshje ndërmjet AKBN, Albpetrolit dhe partnerit(eve) të huaj, zgjidhen përfundimisht sipas Rregullave të Pajtimit dhe Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë ("ICC")...."*

- ✓ Kërkesa për arbitrazh nga ana e Pasditësit, shoqërisë "GBC OIL Company Ltd", ish shoqëria "TransAtlantik Albania", ish shoqëria "Stream Oil & Gas Ltd", ka konsistuar kryesisht në gjykimin e mosmarrëveshjeve të lindura për marrëveshjet hidrokarbure të lidhura midis MIE/AKBN-së dhe shoqërisë "TransAtlantik Albania", në mënyrë të përmbledhur për sa vijon:
 - Pagesën/kompensimin nga ana e MIE/AKBN dhe shoqëria "Alpetrol" sha, në cilësinë e palës së paditur, shumës prej 12,577,852.1 USD, e cila është paguar nga ana e Paditësit dhe nuk është neutralizuar nga AKBN dhe MIE, në përputhje me parashikimin e nenit 3.1(c) të Marrëveshjeve të Licencës, në mënyrë që në përputhje me mekanizmin ligjor të përshkruar në seksionin 6.1.C.(2), të Licencë Marrëveshjeve respektive.
 - Dëmshpërblim për shkeljet e pretenduara nga Palët përgjegjëse të Marrëveshjeve të Licencës së Cakranit dhe Gorishtit. Kjo shumë përfaqëson taksën e Rentës Minerale, të paguar nga shoqëria për vitet 2009-2017, në zbatim të dispozitave të stabilitetit fiskal, sikurse cituar më sipër.
 - Fitimin e munguar që ka pësuar shoqëria, për Marrëveshjen hidrokarbure, Cakranit dhe Gorishtit, përkatësisht 21,184,000 USD dhe 23,514,000 USD.
- ✓ Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, me Urdhrin nr. 508, datë 07.06.2018 "Për kryerjen e pagesave në çështjen ICC Case 22676, GBC VS MIE, AKBN & Alpetrol", në pikën 1, të këtij urdhri, ka urdhëruar:

"Të gjitha pagesat lidhur me çështjen ICC Case no.22676 GBC vs MIE, AKBN & Alpetrol, të avokatëve, ekspertëve, kostove administrative të Tribunalit dhe cdo shpenzim tjetër i lidhur me këtë çështje, pasi miratohet nga Avokatura e Shtetit, të kryhet në masën 100 % nga shoqëria "Alpetrol" sh.a, si shoqëria kontraktore e marrëveshjes hidrokarbure".

- ❖ Vendimi, Case no. 22676/GR, datë 06.07.2020, i Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, ka konsistuar në:
 - i) *Vendos që i padituri 1 (Parë) në këtë arbitrazh është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e Republikës së Shqipërisë (si pasardhësi ligjor i Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë sipas License Marrëveshjeve);*

- Vendos që ka juridiksion për të dëgjuar pretendimet kundër MIE, AKBN dhe AlbPetrol, që i përkasin fushës së Licencë Marrëveshjes Cakran, Licencë*
- iii) *Marrëveshjes Gorisht dhe Licencë Marrëveshjes Ballsh;*
 - iv) *Vendos MIL dhe AKBN kane shkëlur detyrimet e tyre për të zbatuar masat e stabilizimit fiskal sipas nenit 3.1(c), të Licencë Marrëveshjes Cakran. License Marrëveshjes Gorisht dhe Licencë Marrëveshjes Ballsh;*
 - v) *Rrjedhimisht urdhëron MIE dhe AKBN t'i paguaje paditësit shumën prej 12,557,852,1 USD. si demshperblim për shkeljen e detyrimeve të tyre, sipas nenit 3(c) të Licencë Marrëveshjes Cakran, Licencë;*
 - vi) *Rrezon pjesën e mbetur të kërkesave të Paditësit për një shpërblim demt monetar për shkeljet e ndryshme të të Paditurve të Licencë Marrëveshjes Cakran. Licencë Marrëveshjes Gorisht;*
 - vii) *Rrëzon kërkesën e paditësit për dëmet monetare sipas Licencë Marrëveshjes së Ballshit.....;*
 - viii) *Paditësi duhet të paguajë 60% të kostove të arbitrazhit dhe të paditurit duhet të paguajë 40 % të kostove.....: Rimbursimi i të paditurve ndaj Paditësit do të ketë interes në normën 5 % nga data e këtij vendimi deri në bërjen e pagesës së plotë;*
 - ix) *Për pasojë, urdhëron që të paditurit ti paguajnë Paditësit shumën prej 292.760 USD dhe 1445168 Euro, me interes në normën 5 % që nga data e këtij vendimi deri sa të bëhet pagesa e plotë;*
 - x) *Urdhëron që secila palë do të paguajë tarifën e saj ligjore;*
 - xi) *Si pasojë hedh poshtë kërkesën e Paditësit për dëmet monetare për vlerën aktuale të shpenzimeve të G&A të shkaktuara "që nga data e humbjes".*
- ❖ *Vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit, nr. 22676/GR, datë 06.07.2020, referuar Vendimit nr. 226/90 Regj Themeltar dhe nr. 49 Vendimi, shpallur më datë 04.05.2021, është njohur nga Gjykata e Apelit, Tiranë, në zbatim të nenit 393-397, e vijues, të Kodit të procedurave Civile.*

Në vendimin e saj, kjo gjykatë ka vendosur:

Lënien dhe dhënien fuqi ligjore për zbatim në Republikën e Shqipërisë, të Vendimit nr. 22676/GR, datë 06.07.2020, të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit, të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Zyrih, Zvicër.

- ❖ *Mbi korrespondencën zyrtare të zhvilluar ndërmjet Avokaturës së Shtetit dhe MIE, AKBN dhe shoqërisë "Alpetrol" sh.a, lidhur me vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit, nr. 22676/GR, datë 06.07.2020.*
- ✓ *Avokatura e Shtetit, me shkresën nr. 1526/28 Prot, datë 06.08.2021 "Përgjigje shkresë tuaj nr.5175 Prot, datë 29.07.2021", drejtuar shoqërisë "Alpetrol" sh.a dhe për dijeni Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe AKBN-së, në përgjigje të shkresës së shoqërisë "Alpetrol" sh.a, ka përcjell një kopje të vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit, nr. 22676/GR, datë 06.07.2020 (International Court of Arbitration of the International Chamber of Commerce, Icc Case No. 22676/Gr), me palë ndërgjyqëse*

shoqëria "GBC OIL Company Ltd" / si palë paditëse, kundër MIE/AKBN dhe Alpetrol, si palë të paditur.

- ✓ AKBN, me shkresën nr. 1879/3 Prot, datë 21.07.2020 "Mbi çështjen e arbitrazhit nr. ICC Case 22676/GR", drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë", sjell në vëmendje se:
 - Nëpërmjet postës elektronike, datë 9 korrik 2020, dërguar nga avokatët e studios përfaqësuese në arbitrazh të palës shqiptare, është përcjellë vendimi përfundimtarë të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit, të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Zyrih, Zvicër, lidhur me këtë çështje.
 - Vendimi ka rrëzuar pretendimet për fitimin e munguar nga shoqëria "TransAtlantik Albania" por ka vendosur që MIE dhe AKBN të paguajnë në favor të shoqërisë "TransAtlantik Albania" vlerën prej 12,577,852 USD, si rimbursim i pagesave të taksës së rentës Minerare të paguar nga kjo shoqëri për vitet 2009-2017, si pasojë e klauzolave të stabilitetit fiskal që gëzonte Marrëveshja e hidrokarbureve.
 - Kërkohet mbështetja e MIE për adresimin e kësaj çështjeje pranë institucioneve përkatëse, të cilët kanë qenë përfitues të rentës minerare.
- ✓ AKBN, e shkresën nr. 1727/4 Prot, datë 13.07.2021 "Mbi masën e sekuestros së njoftuar ga Përmbaruesi Gjyqësorë lidhur me çështjen e arbitrazhit nr. ICC Case 22676/GR", drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë", për dijeni Avokaturës së Shtetit dhe përmbaruesit gjyqësorë, sjell në vëmendje se:
- ✓ Me shkresën nr. 1024, datë 31.05.2021 "Për vënien e masës së sekuestros mbi kreditë e debitorit" dhe shkresës nr. 1246, datë 24.06.2021 "Kujtesë mbi detyrimin ligjorë" i është drejtuar AKBN-së dhe ka paralajmëruar sanksione në lidhje me vendimin e Gjykatës së Arbitrazhit për çështjen ICC Case 22676 GBC, duke risjellë në vëmendje se nuk ka qenë institucion përfitues i Rentës Minerare.
- ✓ Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Infrastrukturës, me shkresën nr. 4523 Prot, datë 09.06.2021 "Kërkesë për informacion", vë në dijeni lidhur me kërkesën e përmbaruesit gjyqësorë privat lidhur me vendosjen e masës së sekuestros mbi kreditë e debitorit/shoqërisë "TransAtlantik Albania", si pasojë e procesit në gjykatën Ndërkombëtare të Arbitrazhit dhe kërkon informacion mbi statusin e çështjes së Arbitrazhit dhe njohjen e saj në Shqipëri.
- ✓ Avokatura e Shtetit, me shkresën nr. 1526/23 Prot, datë 07.07.2021 "Kthim përgjigje tuajës nr. 4523 Prot, datë 09.06.2021" (protokolluar në MIE nr. 4523/3 Prot, datë 08.07.2021, sjell në vëmendje vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit dhe faktin se *"...nga Avokatura e Shtetit, në kuadër të juridiksionit të saj për përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të shtetit Shqiptarë (në rastin konkret të MIE) ka ndërmarrë të gjitha masat për rekursimin e këtij vendimi"*.

Avokatura e Shtetit, me shkresën nr. 1526/28 Prot, datë 06.08.2021 "Përgjigje shkresës Tuaj nr. 5157 Prot, datë 29.07.2021", protokolluar në shoqërinë "Alpetrol" me nr. 51571/Prot, datë 09.08.2021, ka përcjellë pranë shoqërisë "Alpetrol" sh.a dhe për dijeni MIE dhe AKBN, ka përcjellë një kopje të Vendimit të Gjykatës së Arbitrazhit, për çështjen ICC Case 22676 GBC.

Konstatohet se:

- Nuk dokumentohet asnjë dokumentacion zyrtar (memo/shkresë/tërheqje vëmendje apo ndërveprim zyrtar), nga ana e institucioneve përgjegjëse (shoqëria Albpetrol sh.a, si dhe nga ana e MIE, në cilësinë e pronarit shtet/Aksioneri i vetëm), ku të sillet në pah fakti i detyrimit që rezulton për llogari të kontraktorit/klientit TransAtlantik Albania Ltd/ ish-Stream Oil, detyrim ky që rrjedh nga mospërmbushja e detyrimeve kontraktuale, përgjatë dhe me mbylljen e marrëveshjes hidrokarbure, në vlerën 15 997 441.49 dollarë dhe në vlerën 2 845 998 232.16 lekë, përfshirë edhe detyrimet për pagat e punonjësve të paguara nga shoqëria "Alpetrol" sh.a, për llogari të shoqërisë "TransAtlantik Albania L.t.d", për periudhën Dhjetor 2016-Janar 2017, në vlerën 5 826 768 lekë, për punonjësit e Sektorit Cakran-Mollaj. Ky detyrim dokumentohet të jetë kontabilizuar në rregjistrat dhe librat kontabël të llogarive respektive, të shoqërisë "Albpetrol" sh.a.
- Për më tej, nuk dokumentohet të ketë një korrespondencë zyrtare ndërmjet shoqërisë "Alpetrol" sha, AKBN, MIE dhe Avokaturës së Shtetit, ku të jetë kërkuar asistenca e Avokaturës së Shtetit, në cilësinë e institucionit qëndrorë të ngarkuar ekskluzivisht për dhënien e asistencës juridike për institucionet shtetërore dhe entet publike, referuar nenit 16 "Marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me institucionet shtetërore", të Ligjit nr.10 018, datë 13.11.2008 "Për Avokaturën e Shtetit", të ndryshuar, si dhe nenit 6 "Detyrimi për bashkëpunim", të Rregullores "Për marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me institucionet shtetërore dhe entet publike, rolin e avokatëve të shtetit në gjykim si dhe normat e posacme procedurale", miratuar me VKM nr.392/2009, lidhur me problematikën/mosëmarrëveshjet dhe pretendimet respektive të palës shqiptare në Gjykatën Ndërkombëtare të Arbitrazhit/Dhomën Tregtare të Tregtisë, lidhur me detyrimet e krijuara për këtë vendburim në vlerën 15 997 441.49 USD dhe në vlerën 2 845 998 232.16 lekë, në referencë të nenit 19 "Arbitrazhi" pika 19.1, 19.2, 19.5 (detyrim ky i krijuar para lëshimit të urdhrit të ish-Ministrit të MEI nr.431/1 datë 24.01.2017).
- Nuk dokumentohet gjatë gjykimit të çështjes nr. ICC Case 22676/GR, në Gjykatën Ndërkombëtare të Arbitrazhit, të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, të jenë ngritur, pretendime nga pala shqiptare/grupi i përfqësuesve, në këtë gjykim, lidhur me detyrimet e pashlyera të shoqërisë "TransAtlantik Albania L.t.d", ish shoqëria "Stream Oil & Gas Ltd", të cilat rezultojnë të kontabilizuara pranë shoqërisë "Alpetrol" sh.a, përfshirë edhe detyrimet për pagat e punonjësve të paguara nga shoqëria "Alpetrol" sh.a, për llogari të

shoqërisë "TransAtlantik Albania L.t.d", për periudhën Dhjetor 2016-Janar 2017, në vlerën 5 826 768 lekë, për punonjësit e Sektorit Cakran-Mollaj.

- Ngarkohen me përgjegjësi strukturat respektive të Institucioneve sa më lart cituar.

P.s: Përveç sa përmendur në këtë akt konstatim, grupi i inspektimit nuk disponon asnjë praktikë shkresore, e cila të referojë pretendimet/claims të palës shqiptare për sa i përket detyrimeve të krijuara nga ana e kontraktorit "TransAtlantik Albania L.t.d", përgjatë zbatimit të kontratës, me mbylljen e marrëveshjes hidrokarbure datë 19.07.2007, për vendburimin Cakran-Mollaj, e për më tej gjatë zhvillimit dhe përfundimit të procedurës së arbitrazhit, për çështjen "ICC Case 22676/GR".

Akt konstatim mbahet në 8 kopje, të cilat dorëzohen në protokollin e subjektit të inspektimit, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Brenda tre ditëve nga marrja e njoftimit, akt konstatimi duhet të nënshkruhet me ose pa vërejtje nga personat me të cilët mbahet ky akt konstatim.

Pas nënshkrimit, dy kopje mbahen nga subjekti i inspektuar dhe një kopje i dërgohet grupit të inspektimit financiar publik. Pas këtij afati, nëse akt konstatimi nuk paraqitet i nënshkruar me ose pa vërejtje, ai konsiderohet i mirëqenë nga grupi i inspektimit.

Për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

- Z.Enea Karakaci, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm;
- Z.Ilia Gjermani, me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Hidrokarbureve.

Për AKBN:

- Z.Viktor Tushaj, ish Drejtor Ekzekutiv;
- Z.Elion Selmanaj, ish Drejtor Ekzekutiv;
- Z.Adrian Bykyku, me detyrë Drejtor Ekzekutiv, ish Drejtor i Hidrokarbureve

GRUPI I INSPEKTIMIT:

- Z. Shemsi Mikli
- Znj. Ermonela Sina
- Z. Osman Losha